



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura e V-të

Komisioni për Buxhet dhe Financa

Mbledhja nr. 14/15

Prishtinë, më 15.04.2015, ora 11:00

Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës, salla C-203

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR BUXHET DHE FINANCA

Në mbledhje morën pjesë: Naser Osmani, Safete Hadergjona, Latif Gashi, Labinotë Demi-Murtezi, Besa Gaxherri, Bardhyl Meta, Ilir Deda, Bali Muharremaj, Enver Hoti dhe Fikrim Damka.

Mungoi: Bojan Mitić.

Pjesëmarrës të ftuar: Florije Kika, zv.drejtor në KPA, Arben Brahimaj nga KPA, Lulzim Aliaj – Kryesues i KPMSHC, Miran Zeneli dh Islam Cekaj nga KPMSHC, Idriz Balaj, Kryeshef i AMKMK, Albana Hajrizi dhe Adnan Elshani nga AMKMK, Ismet Krasniqi- Sekretar i Kuvendit të Kosovës, Emrush Haxhiaj dh Istret Azemi nga Kuvendi i Kosovës.

Pjesëmarrës tjerë të pranishëm: Lumnije Murtezi-ZPRK, Ramadan Islami nga GIZ, Lumnije Murati-Udhëheqëse e Divizionit-ZPRK, Sylejman Blaku nga Kosova Sot, Berat Thaqi nga GAP Institut, Alketa Bala nga ATRC, Melita Bytyqi-Kelmendi nga PILPG.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Vilson Ukaj, Sabrije Iseini, Dashurije Canolli dhe Merita Zogjani (Praktikante).

Mbledhjen e kryesoi: Naser Osmani, Kryetari i Komisionit.

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhja e mbajtur e Komisionit, dt. 1.4.2015;**
- 3. Shqyrtimi i Raportit vjetor financiar të Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale për vitin 2014;**
- 4. Shqyrtimi i Raportit vjetor financiar të Agjencisë Kosovare të Pronës për vitin 2014;**
- 5. Shqyrtimi i Raportit vjetor financiar të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil për vitin 2014;**
- 6. Shqyrtimi i Raporti vjetor financiar të Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës për vitin 2014;**
- 7. Shqyrtimi i Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve të Kuvendit të Kosovës për vitet 2016-2018;**
- 8. Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari – theksoi se pranuar një shkresë nga Mbikëqyrësi Shtetëror i Agjencisë për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, i cili ka njoftuar se gjindet në udhëtim jashtë vendit dhe ka kërkuar që të shtyhet i raportit financiar të kësaj Agjencie, për një mbledhje tjetër.

Në bazë të propozimit të kryetarit, Komisioni miratoi rendin e ditës me një ndryshim: Shtyrjen e pikës së tretë e rendit të ditës për shqyrtim, për në mbledhjen e radhës së komisionit.

2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura të Komisionit, dt. 1.4.2015

Kryetari - konstatoj se komisioni miratoi procesverbalin, pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Raportit vjetor financiar të Agjencisë Kosovare të Pronave për vitin 2014

Florijs Kika – prezantoi shkurtimeisht shpenzimet e AKP-së sipas kategorive ekonomike, duke krahasuar buxhetin e miratuar, ndryshimet gjatë vitit dhe shpenzimet.

Kryetari - pyeti a është zvogëluar ndonjë kategori tjetër që është rritur buxheti për paga e mëditje?

Arben Ibrahim - rritja e pagave për 25% sipas vendimit të qeverisë, prej prillit 2014, për të gjitha stafin është pasqyruar në buxhetin e pagave dhe mëditjeve të agjencisë. Kurse si rezultat i vendimit të dytë të qeverisë është bërë zvogëlimi i buxhetit prej 15% në mallra e shërbime dhe e komunalit dhe si rezultat i kësaj situatë, janë bërë lëvizjet e brendshme të buxhetit në Agjenci. Përndryshe implementimi i buxhetit është 99% në shumicën e kategorive.

Bali Muharremaj – në lidhje me pagat që i ka rritur qeveria për 25% në vitin 2014, si ka mundësi për disa institucione me pas rritje të pagave e për disa jo?

Kryetari – rritja e pagave është bërë për të gjitha institucionet.

Ilir Deda - siç dimë me ligj do të ndërrohet emri i agjencionit në këtë mandat, a jeni të përgatitur me ndryshimet, përfshirë edhe me koston buxhetore që do ta shoqërojnë këto ndryshime?

Florijs Kika - ne kemi një analizë lidhur me projektligjin që është në Kuvend, por është bërë edhe planifikimi në kornizën financiare dhe përveç 6 pozita staf i riqë janë planifikuar me u marrë, me ndryshime të vogla do të jetë kjo pasqyra financiare edhe në mandatin e ri.

Ilir Deda - është ndër organizata e pakta buxhetore që ka mbërri me realizue shpenzimin e buxhetit, keni kapacitet absorbues dhe planifikim të mirë dhe funksionim më të mirë se të tjerët.

Florijs Kika – për shkak të zvogëlimit të buxhetit nga ana qeverisë për 15%, na është dashur me bërë lëvizje nga shpenzimet kapitale në mallra dhe shërbime dhe komunalit.

Bali Muharremaj - në bazë të raportit keni pasur 42,000 kërkesa, sa janë realizu prej tyre, a keni ndonjë numër?

Florijs Kika – në dhjetor janë bërë rreth 600 ankesa dhe presin në gjykatën supreme për tu vendosur. Mbi 30,000 vendime janë implementuar, 12,000 presin të implementohen gjatë këtij viti, por ne mendoj se deri në qershor të viti të ardhshëm do të implementojm këto vendime.

Enver Hoti – nga raporte shihet se shpenzimet për mallra dhe shërbime janë realizuar siç janë planifikuar. Po ashtu edhe investimet kapitale dhe të gjitha kategoritë tjera janë përshkruar mirë dhe janë realizuar në mënyrë të kënaqshme.

Kryetari - agjencia ka pasur një realizim total të buxhetit prej 96.65%, që do të thotë se kanë pasur një planifikim të mirë dhe nuk ka vërejtje, raporti është i detalizuar.

Pas diskutimeve dhe sqarimeve, kryetari konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë

Rekomandim

I rekomandohet Kuvendit të miratojë Raportin vjetor financiar të Agjencisë Kosovare të Pronave për vitin 2014.

4. Shqyrtimi i Raportit vjetor financiar të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil për vitin 2014

Lulzim Aliaj - theksoi se këshilli, përkundër vëshërësive që ka pasur, në mungesën e anëtarëve, ka arritur të kryejë detyrat dhe të shqyrtoj më shumë se 650 ankesa, ti vëzhgoj procedurat e përzgjedhjeve të nëpunësve drejtues dhe të bëj monitorimin e institucioneve brenda vendit edhe përfaqësive jashtë vendit. Vështërsi ka qenë edhe buxheti i pamjaftueshëm, mungesa e anëtarëve të këshillit, mungesa e hapësirës.

Islam Cakaj - buxheti fillestar i Këshillit për vitin 2014 ka qenë 259,950€, ndërsa buxheti përfundimtar 273,454.79 euro, pra kemi pas një rritje të buxhetit prej 14,246 euro, si pasojë e rritjes së pagave me vendimin e qeverisë prej 25%. Ndërsa kemi pasur një shkurtim të buxhetit në mallra dhe shërbime prej 15% me vendim të qeverisë apo 9,247 euro dhe ky shkurtim ka pas pasoja sepse nuk kemi mundur me i krye obligimet tona, kemi bërë kërkesë dhe qeveria ka pas mirëkuptim dhe na ka lejue 10,000 euro për këtë qëllim. Po ashtu kemi pasur zbritje të buxhetit për komunalit prej 15% sipas vendimit të qeverisë. Marr në përgjithësi buxheti nuk ka qenë i mjaftueshëm në vitin 2014, kemi pasur të bartura 5,130 euro obligime që kanë rrjedhur nga viti kaluar. Automjete që i kemi në shfrytëzim prej vitit 2001 dhe 2002, janë të stërvjetruara apo na ngarkojnë me shpenzime të karburanteve dhe servisim dyfish më shumë.

Safete Hadergjonaj – te shpenzimet e buxhetit për paga, ajo që më bënë përshtypje është fakti se si i keni harxhuar të gjitha mjetet apo 100% në këtë kategori, kur disa anëtarëve të Këshillit iu ka kaluar mandati, dhe nuk keni arritur të rekrutoni një punëtor të planifikuar?

Miran Zeneli – për shkak të mungesës së disa anëtarëve të Këshillit dhe duke pasur parasysh ngarkesën e madhe në shqyrtimin e ankesave brenda afatit ligjor, Këshilli ka vendosur që të bëjë një lloj stimulimi për anëtarët me bashkëpunëtorët profesional, ku është paguar një shtesë prej 520 eurove në emër të orarit jashtë pune dhe kjo është paguar nga fondi i mjeteve të akomoluara. Vendimi i Këshillit është bërë në bazë të rregullores së brendshme.

Safete Hadergjonaj – pyeti përfaqësuesit e Këshillit, se në çka e keni bazuar vendimin?

Miran Zeneli – në pyetjen e parafolësës, sqaroi se në bazë të ligjit për Këshillin dhe me rregulloren e brendshme.

Safete Hadergjona – është një shprehje e institucioneve të pavarura të cila i raportojnë Kuvendit, se qdo mjet që iu tepron e shpërndajnë të punësuarve të vetë, e kemi pasur rastin me Zyrën e Rregullatorit të Energjisë. Për çdo shtesë për anëtarët e Këshillit apo për të punësuarit të tjerë, ju duhet kërkesën me e sjellë në Kuvend për aprovim. Nuk ka bazë ligjore dhe nuk është e arsyeshme me u shpërnda e me u shfrytëzue mjete në këtë formë siç është bërë nga Këshilli.

Miran Zeneli – mjetet që kanë tepruar nuk janë marrë vetëm për anëtarët e këshillit, por i kanë marr edhe zyrtarët financiar, pasi që ata që kryen punë të duplikuara, me qëllim që të mbulohen funksionet që i parasheh ligji për menaxhimin e financave publike, janë stimuluar me nga 90 euro.

Safete Hadergjona – a i ka aprovuar ministria këto mjete?

Miran Zeneli - ministria nuk i ka aprovuar, por ne i miratojmë vetë.

Kryetari - ekziston një mekanizëm, se jashtë pagës dhe mëditjes, për shtesat tjera duhet një pëlqim apo një vendim prej ministrisë së administratës publike. Në raportin si të tillë e pranojmë, por nuk e pranojmë kurrfarë kompensimi jashtë orarit të punës, për arsye se nuk është e rregullme me ligj dhe ne në seancë do ta bëjmë këtë vërejtje.

Lulzim Aliaj – në këtë vit nga Kuvendi i Kosovës janë miratuar 5,000 euro, për me i mbulue këto kategori të zyrtarëve që kanë kryer punët të dyfishta në vitin e kaluar, sepse ne nuk kemi as certifikues e as zotues, e as pranues të mallrave. Në pajtim me ligjin për shërbyesve civil, lejohet maksimum deri në 40 orë punë jashtë orarit. Ne kemi të drejtë ti ngarkojmë nëpunësit edhe me punë tjera.

Kryetari – ne nuk kemi leju mjete shtesë për kompensim për punën jashtë orarit, e mos të keqkuptohemi këtu, ne nuk kemi marrë vendimi asnjëherë për këtë çështje. Ju e keni pasur një të punësuar më pak, ju kanë mbetur këto mjete, por nuk ju arsyeton me i harxhue mjetet qindpërqind.

Latif Gashi - ju e dini sa keni bërë zhurmë për me iu leju me marr një ekspert dhe ky komision e ka lejuar këtë pozitë dhe ndarë buxhetin, pse nuk e keni pranuar atë ekspert dhe ku ka mbetur ai buxhet?

Lulzim Aliaj - përderisa procedura është miratuar në ministrin e administratës publike dhe është miratuar në ministrinë e financave, ne konsiderojmë që kemi punuar me rregulla. Sa i përket procedurës së rekrutimit të anëtarit, e kemi zhvilluar procedurën e konkursit të brendshëm dhe për shkak të ankesave dhe në bazë të rregullave që parasheh shërbimi civil, procesi ka qenë i pezulluar. Pas përfundimit të procesit të brendshëm është zhvilluar dhe procedura e jashtme dhe përsëri kemi pasur ankesë edhe lënda ka shkuar në gjykatë. Tek në muajin e kaluar kemi vendos si Këshill për anulimin e kësaj procedure për shkak të shkeljeve procedurale dhe tani rishpallet përsëri pozita.

Latif Gashi – ne na intereson se ku është buxheti. Si guxon me shfrytëzue buxhetin për 3 anëtarët e Këshillit, kur mjetet kanë qenë të planifikuar për një punëtor apo ekspert. Ju këtë buxhet e keni shpenzuar për shtesa tjera dhe kjo konsideroj është shkelje ligjore.

Ilir Deda - ju thatë se keni pasur aprovim prej ministrisë të administratës publike dhe ministrisë së financave, a mundemi me pa këtë aprovim me shkrim, nëse i keni aprovimet prej këtyre institucioneve?

Lulzim Aliaj - ministria e financave dhe ministria e administratës publike pas kërkesës që ju është drejtuar nga sekretariati i këshillit, ka proceduar këto paga dhe ka pas takime të dyanshme dhe janë diskutuar këto çështje.

Kryetari - procedurat janë kështu, institucioni kur ka një kërkesë të tillë, duhet ti drejtohet ministrisë së administratës publik dhe ministrisë së financave, dhe për këto çështje të shtesave, qeveria nxjerr rregullore.

Besa Gaxherri – për mendimin tim është një shkelje shumë e rëndë ligjore dhe ne si komision nuk mundemi me e dërgue në Kuvend e me thënë se e kanë bërë një shkelje dhe i falet, por duhet të kërkojmë që këta të japin përgjegjësi.

Kryetari - tek mallrat e shërbimet, keni tejkalime për 118%, tejkalim për mëditjet në udhëtimet jashtë vendit, akomodimi i udhëtimit dhe shpenzimet tjera jashtë vendit 218% tejkalim.

Miran Zeneli - ky tejkalim ka ardhur si rezultat që Këshili çdo fillim vit bënë plane për ushëtime jashtë vendit, vizita monitoruese dhe janë realizuar 3 vizita, në Angli Francë e Turqi.

Enver Hoti - në bazë të funksionit që keni si Këshill, ju e keni edhe për detyrë me i shqyrtue të gjitha ato ankimime të të gjitha institucioneve, që mundeni me ra në shkelje me kriteret në procedurat e rekrutimit dhe në bazë të kësaj ka një evidencë se 134 raste i keni aprovuar. A e keni cekur në raport se për shkak të pamundësive financiare dhe kushteve, nuk mundeni me i hetue rastet deri në fund? Sa i kushton buxhetit të Kosovës kur vendimet e juaja nuk zbatohen nga institucionet përkatëse, qoftë lokale apo qendrore, sepse mandej kalojmë në procedura tjera gjyqësore, të cila mund të dëmtojnë organizatën buxhetore përkatëse. Do do të ishte mirë në herën tjetër me e dite se sa dëmtohet buxheti në këto veprime.

Lulëzim Aliaj - edhe ne jemi shumë të shqetësuar për mos zbatim të vendimeve të Këshillit dhe si pasojë edhe dëmtim të buxhetit të Kosovës. Këtë shqetësim e kemi paraqitur para kryetarit të kuvendit dhe para kryeministrit. Përkundër punës së madhe që është bërë, i kemi 54 vendime që nuk janë zbatuar. Kemi problem sepse gjykatat në vitin 2015 janë duke i zgjedhur lëndët që kanë qenë në vitin 2009 apo 2010, e ne nuk mundemi me pas nje raport për me e pa se sa është dëmtuar buxheti i Kosovës.

Kryetari – sa i përket mallrave dhe shërbimeve buxheti është realizuar në 99.82% dhe tejkalimet janë në disa nënkategori e nuk ke pas nevojë me u marr pëlqimi nga ministria. Çështja e shqetësimeve që u ngriten për shtesa jashtë orarit të punës, është edhe një institucion që mirret më këto, që është Auditori Gjeneral, që e konstaton zbatueshmërin e ligjeve për çështje financiare.

Safete Hadergjona - institucionet e pavarura që raportojnë Kuvendit, jemi të detyruar që ti fusim në sistem, dhe në këtë drejtim ne si komision për buxhet, duhet të jemi shumë të kujdesshëm me rastin e miratimit të buxhetit të tyre. Një çështje tjetër është që këto institucione të pavarur duhet neve si komision të na sjellin raportin në mënyrë të detalizuar, për të parë se kush po shkon nëpër këto udhëtime jashtë vendit, a janë të punësuarit apo anëtarët e këshilleve apo bordeve. Pra unë konsideroj se për këto institucione përgjegjësia është e Kuvendit dhe nuk është as Qeverisë e as institucionet tjera, sepse ne jemi përgjegjës për mbikëqyrjen e tyre. Ne duhet të kërkojmë që Auditori të na bjen auditimin, për të parë rregullsinë ligjore, se si është bërë lëvizja e mjeteve dhe me e pa se a është bërë shkelja e dispozitave ligjore.

Kryetari – për këto çështje kam me pas fjalën në seancë, por vërejtja nuk i dedikohet vetëm këtij institucioni, por krejt institucioneve të pavarura, që veprojnë në mënyrë të tillë.

Besa Gaxherri – nuk është agjensioni i vetëm që po i ndodhin gjëra të tilla, që bëhet shpërndarja e mjeteve tek pagat që vërtet është krejtësisht e papranueshme. Ne duhet të nxjerrim një rekomandim dhe me kërkuje prej auditorit që për të gjitha agjencitë të bëhet auditimi i performancës.

Pas diskutimeve dhe sqarimeve, kryetari konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë

Rekomandim

I rekomandohet Kuvendit të miratojë Raportin vjetor financiar të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil për vitin 2014.

5. Shqyrtimi i Raporti vjetor financiar të Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës për vitin 2014

Albana Hajrizi – theksoi se buxheti total i shpenzuar për vitin 2014 ka qenë 772,991.46 euro. Agjensioni ka zbatuar vendimin e qeverisë për kursim prej 15% tek mallrat e shërbimet dhe komunalit. Shpenzimet komunal kanë të bëjnë me borxhet e ujësjellësit dhe të energjisë elektrike në kompleksin memorial Adem Jashari dhe mjetet janë bartura nga investimet kapitale sipas kërkesë tonë dhe me miratimin e Ministrisë së Financave. Sa i përket investimeve kapitale, për kompleksin Adem Jashari janë shpenzuar 600,47,119.23 euro. ndërsa për mirëmbajtje të kompleksit janë shpenzuar 28,480.14 euro, ndërkaq me vendim të qeverisë, mjete që kanë qenë të pazotuara janë tërhequr në tetor. Shpenzimet tjera për këtë projekt, ka të bëjnë me mirëmbajtjen e webfaqes së kompleksit memorial, krijimin e webfaqës së agjencionit dhe vendosja e një gypi të ujësjellësit në shumë prej 75,114.95 euro.

Ilir Dedaj - pyeti për një gyp të kanalizimit është kjo shuma prej 75,114 euro?

Idriz Blakaj – sqaroi se gypi i ujësjellësit përfshin dhe furnizimin me ujë, pompat, bazenat dhe gypi është 14 km i gjatë.

Ilir Dedaj – sa komplekse memorial keni në mbikëqyrje dhe financiarisht sa mundeni me i mbulue?

Idriz Blakaj – me ligj ne e kemi në përgjegjësi për mirëmbajtjen e të gjitha komplekseve dhe është dashtë me qenë në agjencionin tonë, por kanë mbetur në ministrinë e planifikimit hapësinor. Ne kemi bërë kërkesë institucioneve përkatëse dhe projektet nuk janë bartur.

Ilir Deda - për të punësuarit ju theksuat se gjatë vitit 2014, i keni pas të aprovuar 9 pozita, dhe ende nuk i keni ata të punësuar?

Idriz Blakaj - ata janë të punësuar po nuk kanë qenë prej 1 janarit.

Enver Hoti - kur pritet me përfundue puna e projektit memorial Adem Jashari, a keni mjete të mjaftueshme me përfshi të gjitha projektin, duke përfshirë edhe konservimin e kompleksit?

Idriz Blakaj – përfundimi i kompleksit memorial Adem Jashari varet prej mundësive buxhetore. Kompleksi ka disa projekte që janë të kushtueshme. Siç është rasti me projektin amfiteatri veror, që është punuar nga ministria dhe kushton dikun rreth 10 milion euro. Në trendin që është aktualisht ndarja e mjeteve buxhetore, unë jam i bindur që shkojnë edhe dhjetë vite e nuk kryhet, sepse kompleksi përfshin një sipërfaqe prej 450 hektarësh. Projekti i konservimit të kullave është në procedurë dhe në mungesë të ekspertëve të lamisë se konservimit në Kosovë, na është dashur më angazhues ekspert ndërkombëtar, dhe ata nuk kanë mundur të vijnë kur kemi pas nevojë dhe për këtë arsye është vonuar projekti dhe tani ky projekt është në përfundim.

Latif Gashi - për projektin e Koshares edhe varrezat e dëshmorëve në Penuh, mjetet për të cilat projekte agjencioni i ka të ndara me buxhetin e këtij vit, deri ku keni arritur me punë dhe çka duhet na si komision me bërë që të përfundohen këto projekte?

Idriz Blakaj - ne si agjension nuk kemi bërë asgjë as për Koshare e as për Penuh, sepse nuk ka qenë projekti tek ne. Kërkojë prej komisionit që me e bërë një presion tek ministria e mjedisit, që projektet të barten në agjenci. Por ne nuk po mundmi me shpall tenderin pa e dite sa mjete kanë me u ndarë në rishikim të buxhetit.

Latif Gashi - jo rusishtë e ngrita këtë çështje, duke marrë parasysh se ai buxhet që është ndarë për dy komplekse është i vogël dhe duke marrë parasysh procedurat e tjera të prokurimit, ka me shkue në suficit. Unë kërkoj nga koleget që për këto dy projekte me e bërë një zotim tonin dhe do ti përkrahim që të kryhen. Por edhe ju si agjenci edhe me atë shumë që ke ti filloni procedurat dhe na njoftoni në rishikim të buxhetit për mjetet tjera duhen, që të ecin dy projektet.

Safete Hadergjonaj – theksoi se gjashtëmbëdhjetë vitet pas lufte ende nuk i kemi rregulluar këto varreza të dëshmorëve e memoriale dhe ende nuk e kemi zgjidhur këtë problem. Për rastin në Koshare është ndjenë e keqe që kur i kam pa familjarit afër ulur tek varret, e njerëzit nuk janë në ato varre, dhe janë më murgë në Prishtinë apo Rahovec, për mua ka qenë një ndjenjë e keqe ta shohësh një situatë të tillë, që nuk mundem me përshkrue. Në Penuh i kemi varrezat e të zhdukurve të pa rregulluara, po ashtu në Mejë nuk ka përfunduar kompleksi. Ne duhet me e shikue mirë kur të na vjen rishikimi i buxheti e ti qartësojmë njëherë e mirë raportet e ministrisë dhe agjencisë, dhe ai institucion që e ka obligimin me ligj, ta merr përmby vete këtë përgjegjësi dhe të bëjmë atë çka mundemi dhe duhet bërë.

Besa Gaxherri – në bazë të kësaj çka u tha deri më tash dhe raportim që e kemi përpara, ne jemi në një situatë të dhimbshme. Është ngritur një agjension për komplekse memoriale, ndërsa ky agjencion ka nën menaxhim vetëm një projekt të kësaj natyre. Ne duhet që ose t'ia ndrojmë emrin këtij agjencioni ose ti bartim të gjitha projektet e komplekseve. Ne shumë shpesh në seancë e shfrytëzojmë rastin e dalim prej kufijve të politikanit bëjmë biznes me këtë temë. Ne duhet me qenë real dhe është e kuptueshme se duhet me ndërtue shumë komplekse por nuk kemi para. Kështu që, sa janë investuar për kompleksin Adem Jashari, ka nevojë edhe për kompleksin e Koshares apo tjetrin kompleks që është Penuha. Ne kemi obligim për ta, por ne kemi edhe njerëzit e gjallë që po u mungon buka. Ne duhet të kemi konsideratë me vetvete dhe të gjitha për një vit nuk mundemi me i ba. Por realisht janë 15 vite dhe në Koshare nuk është bërë asnjë gjë. Ju si agjenci shpalleni projektin, në rishikim kemi me nda një pjesë të mjeteve e një pjesë vitin tjetër, por Kosharja është prioritet.

Latif Gashi - agjencioni është krijuar për projekte të reja edhe për mirëmbajtjen e projekteve që kanë përfundue. Se është prioritet Kosharja është e vërtetë, por po ashtu edhe më shumë prioritet është edhe projekti në fshatin Penuh, se dëshmorë janë atje e dëshmorë kemi këtu.

Ilir Deda – ne çfarë po duam të themi është se ne po dojmë me depolitizue këtë lloj diskutimi e me i dhënë mbështetje Projektit të Koshares që është prioritet, e ndonjë tjetër nëse ka mjete, e me ju tregu se gjithë njëzëri kemi me e përkrah në rishikim të buxhetit.

Enver Hoti – unë e di edhe që në të gjitha komunat, drejtorit përkatëse, e kanë një kujdes për varrezat e dëshmorëve dhe kanë investuar, prandaj nuk është aq e thjeshtë siç po e përshkruani ju. Komplexet do i mbështesim të gjithë dhe po më duket pak marketing sepse edhe atje ka një buxhet lokal. Është mirë nëse ka mundësi me e bërë një identifikim të gjendjes së komplekseve e varrezave dhe për shtëpitë që janë si muze.

Bardhyl Meta - çka ju duhet juve edhe qka mundemi me bërë ne sot për me procedue me këtë projektin e Koshares, sepse ne nuk mundemi me iu thënë familjarëve se në verën tjetër i rregullojmë varrezat.

Idriz Blakaj - një kërkesë e imja është që mundësisht me u depolitizu çështja e komplekseve. U tha se a prioritet është Kosharja e Penuha, por edhe unë po e shtoj edhe një shumë të madh që është Marina dhe këto janë prioritetë shumë të mëdha. U po them se ka shumë projekte në infrastrukturë dhe çështjet tjera që janë shumë më pak të rëndësishme se këto, dhe kemi obligim të madh ndaj atyre njerëzve. Përveç realizimit të projekteve kërkohen mjete dhe për mirëmbajtjen e tyre.

Kryetari - kërkojmë prej agjencisë se kur fillojnë dëgjimet buxhetore për buxhetin 2016, të vijmë me prioritetë konkrete dhe duhet ta kenë një plan të detalizuar për ndërtime e mirëmbajtje, për të gjitha kompleksët dhe monumentet që janë në kuadër të tyre. Po ashtu unë do të kërkojë në seancë që ministritë përkatëse, e sidomos ministria për planifikim hapësinor, mjete e dedikuar për mbajtjen e monumenteve të adresohen në agjenci.

Pas diskutimeve dhe sqarimeve, kryetari konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë

Rekomandim

I rekomandohet Kuvendit të miratojë Raportin vjetor financiar të Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës për vitin 2014.

6. Shqyrtimi i Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve të Kuvendit të Kosovës për vitet 2016-2018

Ismet Krasniqi – theksoi se KASH i Kuvendit për periudhën 2016-2018 është punuar nga administrata dhe janë caktuar të gjitha detajet që mendojmë se kemi arritur të identifikojmë ato çështje të cilat në njëfarë mënyre janë vazhdimësi e punës sonë, me një konstatim se nga mbledhja e kryesisë që është mbajtur sot, që te pjesa e investimeve kapitale për vitin 2016-2018, të shtohet edhe një projekt që është në biseda me donatorë të ndryshëm, që të kemi kanal in televiziv për Kuvendin. Është një ide e kamotshme dhe është një përpjekje për një transparencë sa më të madhe të punës së pjesës politike dhe punës së komisioneve. Televizioni është menduar të funksionojë në kuadër të RTK-së, po me tendencë që të pavarësohet. Projekti fillestar është paraparë të jetë në një shumë totale prej 800,000 euro, 200,000 euro në vitin 2016, 500,000 euro në vitin 2017 dhe faza përmbyllëse në vitin 2018 prej 100,000 euro.

Kryetari – theksoi se një çështje nuk po më pëlqen, nëse duhet sot me marr vendim dhe nuk dua të biem nën presion të kohës. Sa i përket çështjes së projektit Vila Gërmia, është një projekt që ka kushtuar miliona edhe është ndërprerë puna dhe për tre vitet e ardhshme nuk pritet asnjë investim në të. Por unë dua me zhvillue bisedë edhe me kryetarin e parlamentit për këtë dhe me ditë fatin e atyre investimeve, që nuk janë të vogla. Problemi kryesor me këtë dokument është tek investimet kapitale që kërkohen të sqarohen. Kjo puna e rinovimit të ndërtesës nuk po na përfundon kurrë. Por edhe më tutje deputetët nuk kanë zyre. Projekti që po më duket i arsyeshëm është një arkiv e digjitalizuar.

Latif Gashi - çështjen e projektit “Villa Gërmia”, e kemi diskutuar shumë në mandatin e kaluar dhe është një çështje shumë e ndishme, dhe për sa më kujtohet e kemi porositur Sekretarin me u interesue për pengesat në këtë projekt, kur dihet që ka një kontest gjyqësor dhe të njoftohemi si komision. Është një projekt mjaft i rëndësishëm, por përgjigjen e kemi marrë se ka një kontekst gjyqësor dhe nuk mundemi me bërë investime. Por unë prapë po kërkojë se duhet të njoftohemi për gjendjen e këtij projekti dhe për kontestin gjyqësor në mënyrë juridike.

Ilir Deda - kam një seri të vërejtjeve rreth dokumentit të propozuar. Komisioni për Legjislacion është e është duke e hartuar Ligjin për Kuvendin dhe me këtë ligj ne kemi detyrime shtesë për shkak të MSA-së dhe në këtë Kornizës, nuk është e paraqitur shtesa e kostos totale të Kuvendit për këtë proces. Do të ketë nevojë për rritje me staf profesional, sepse në çdo komision do ta mbikëqyrë realizimin e MSA-së në fushat e veta. Por në total është e papranueshme që buxheti i Kuvendit të Kosovës me qenë më i vogël se buxheti i RTK-së. Siç e dimë është edhe kërkesë e BE-së që Kuvendi duhet të miratojë vetë buxhetin, pas asnjë ndikim dhe as nga Ministria e Financave. Projektet kapitale siç janë prezantuar si të tilla nuk janë të pranueshme dhe nuk mundemi me i diskutue kaq shpejtë. Nëse duhet renovim i ndërtesës, duhet renovim komplet me një sezon dhe me e pa projektin. Po ashtu, Kuvendi ka rol të jashtëzakonshme në diplomacinë parlamentare dhe në këtë drejtim do të shtohen aktivitetet, kur kemi parasysh edhe procesin e MSA-së, dhe ne duhet me i parapa shpenzimet të cila do të vijnë. Po ashtu duhet të zgjidhet çështje e projektit Vila Gërmia, ndërsa kjo çështja e automjeteve është e panevojshme që të ndahen mjetet pa nevojë. Gjithashtu duhet të krijohen hapësirat për punë për deputetë.

Besa Gaxherri - unë mendoj se sot nuk mundemi me e përfundue punën e këtij dokumenti. Investimet kapitale duhet ti diskutojmë seriozisht, të gjitha projektet që janë planifikuar. Janë bërë 15 vite dhe ende po vazhdohet me rinovimin e ndërtesës. Deputetë nuk kanë hapësira për punë. Projekti Villa Gërmia duhet të përfundojë. Po ashtu kërkohet sqarim për blerjen e veturave. Ajo që po më pëlqen shumë është projekti për digjitalizimin e arkives dhe për këtë kemi diskutuar prej GIZ-it ne na mbështet që komisioni me pas një arkiv të tonën. Sa i përket kanalit televiziv të Kuvendit, duhet me na shpjegue mirë sepse kemi problem me RTK-në, dhe tash me i nda mjetet shtesë këtij televizioni nuk pajtohem.

Bardhyl Meta - pajtohem se duhet të rishikohen projektet kapitale. E kemi thënë edhe më herët, duhet përmirësuar kushtet për deputet. Sa i përket projektit të Villa Gërmisë nëse nuk investohet, ka me u shëndrruar në Urën e Shejtë dhe asgjë nuk na vlen më. Sa i përket kanalit të Kuvendit, të gjitha shtetet e kanë një kanal të tillë që pasqyrohet puna e Kuvendit. Por lidhur me propozimin për vendosjen e tij në RTK, unë mendoj se nuk mund ti ndahen 800,000 euro RTK-së, por duhet hapet tender dhe të bëhet një ofertë që ka të bëjë me punësimin e 20 vetave.

Kryetari - e kam një propozim që të caktojmë një grup punues e ta rishikojmë më mirë këtë kornizë, dhe nuk jam për me krye kështu blanko. Të caktohem tre veta, të diskutojmë këtë material dhe ta japim versionin final.

Latif Gashi - nuk e di kohën se kur duhet me u dorëzue ky dokument, por kjo duhet me qenë kohë emergjente, por të gjitha partitë politike e kanë përfaqësuesin e tyre në Kryesi dhe kjo kornizë afatmesme ka kaluar nëpërmjet Kryesisë dhe të gjitha kanë mundur me shikue dhe me i dhënë vërejtjet. Kjo është vazhdimësi e punës e të gjitha kryesive të mëhershme dhe jam dakord që ta kalojmë që të jemi brenda afatit ligjor.

Sekretari - një sqarim për afatin e dorëzimit të kornizës, ne e kemi marrë dokumentin nga ministria e financave me 4 prill dhe deri me 14 prill është afati me dorëzue, ndërsa ne në komision e kemi dërguar me 8 prill. Për vërejtjet që i ngritet, ne i kemi dhënë spejgimet në brendësi të materialit dhe vetëm për MSA-në nuk ka informacion.

Kryetari - në këtë mënyrë e kemi vështirë me e kalue këtë dokument sepse vërejtjet janë konkrete dhe ne kërkojmë që brenda javës të diskutojmë dhe të japim versionin tonë dhe pastaj të dërgohet në Kryesi.

Enver Hoti – unë i mbështesë projektet kapitale, por investimet por projektin Villa Gërmia nuk mundem ta mbishtesë. Kjo do ti kushton Kuvendit duke përdorur vende të tjera për shërbimet e veta.

Pas diskutimeve dhe në bazë të propozimit të kryetari, Komisioni njëzëri nxori

Vendosi

Caktohet grupi punues për shqyrtimin e Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve të Kuvendit të Kosovës për vitin 2016-2018, të përgatitur nga Administrata e Kuvendit dhe përgatitjen e versionit final që i bashkëngjitet rekomandimit të komisionit për Kryesinë e Kuvendit.

7. Të ndryshme

Kryetari – njoftoi anëtarët e komisionit, se rekomandimi i Komisionit lidhur me buxhetin e Komunës së Prishtinës, i është dërguar Ministrisë së Financave, që buxhetin e riaprovuar nga Komuna e Prishtinës së bashku me dokumentet e dorëzuar, të pasqyrojë në tabelat buxhetore të Ligjit të Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2015. Po ashtu kryetari njoftoi se në emër të Komisionit, ka dërguar një shkresë Drejtorisë për hulumtime në Kuvend, që të kërkojë nga projekti i KDI-së, që financohet nga USAID, të bëjë një hulumtim legjislativ lidhur me heqjen e taksës së pagesës së taksës kufitare për automjetet me targa të huaja që hyjnë në Kosove.

Mbledhja përfundoi në ora 13:20

Përgatitur nga:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Naser Osmani